- ✓ Ka nje qellim per te zgjidhur ceshtjen ne mbi bazen neto, ose te realizohet aktivi dhe te shlyhet detyrimi ne te njejtën kohe

v) Vlera e drejte e instrumentave financiare

Per instrumentat financiare qe nuk tregtohen ne tregje aktive, vlera e drejte percaktohet duke perdorur teknika vleresimi te pershtatshme. Teknika te tilla mund te perfshijne:

- ✓ Perdorimin e transakcioneve aktuale me vlerat e tregut
- ✓ Referimin e vleres se drejte aktuale te nje instrumenti qe eshte thelbesisht i njejtë
- ✓ Nje analize te flukseve monetare te skontuara ose modele te tjera vleresimi.

f) Inventaret

Inventaret jane vleresuar me me te voglen ndermjet koston dhe vleres neto te realizueshme. Kosto e inventareve bazohet ne metodën e Koston Mesatare, dhe perfshin shpenzime te hasura ne blerjen e inventareve, prodhimin apo kostot e transformimit dhe shpenzime te tjera te hasura deri ne sjelljen e tyre ne kushtet dhe vendin ekzistues.

Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i shitjes i pritur ne kushtet normale te biznesit, minus kostot e pritura te perfundimit dhe shpenzimet e nevojshme te vleresuara per te kryer shitjen.

g) Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Shoqeria vlereson ne cdo date raportimi nese ka shenja qe tregojne qe nje aktiv mund te kete pesuar renie ne vlere (zhvleresuar). Nese ka tregues te tille, ose kur kerkohet nje testim vjetor per zhvleresimin e nje aktivi, Shoqeria vlereson shumën e rikuverueshme te aktivitetit. Shuma e rikuverueshme e nje aktivi eshte me e larta ndermjet vleres se drejte minus kostot e shitjes se aktivitetit apo njesise gjeneruese te parase (NGP) dhe vleres ne perdorim te saj dhe percaktohet per nje aktiv te vecante, pervec kur aktivi nuk gjeneron te hyra monetare qe jane thelbesisht te pavarura nga ato te



L517/5010G
Rruga e Kavajës, Nd. 124, H. 10, Kati 2,
Kod Postar, 1023,
Tiranë, Albania

Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

aktiveve te tjera apo grupeve te aktiveve. Kur vlera e mbartur e nje aktivi ose NGP tejkalon vleren e rikuperueshme, aktivi konsiderohet i zhvleresuar dhe pakesohet deri ne vleren e rikuperueshme te tij. Ne percaktimin e vleres ne perdorim, flukset monetare te vleresuara skontohen ne vleren aktuale duke perdorur nje norme skontimi para tatimit qe reflekton vleresimin aktual te tregut te vleres ne kohe te parase dhe risqet specifike te aktivitetit. Ne percaktimin e vleres se drejte minus kostot e shitjes, meren ne konsiderate transaksionet me te funditte tregut, nese jane te disponueshme. Nese transaksione te tilla nuk mund te identifikohen, perdoret nje model vleresimi i pershtatshem. Keto llogaritje vertetohen nga perberes te vleresimit, cmimet e aksioneve te kuotuar per filiale te tregetuara publikisht ose tregues te tjere te vleres se drejte te gatshem.

Humbjet nga renia e vleres prej operacioneve te vazhdueshme, duke perfshire zhvleresimin e inventareve njihen ne pasqyren e te ardhurave ne kategorite e shpenzimeve ne perputhje me funksionin e aktivitetit te zhvleresuar, pervec aktiveve afatgjata materiale te rivleresuara me pare dhe rivleresimi eshte kaluar ne te ardhurat e tjera gjithepershires.

Ne kete rast, renia e vleres njihet gjithashtu ne te ardhurat e tjera gjithepershires deri ne masen e rivleresimit te meparshem.

Per aktivitet , vleresimi behet cdo date raportimi nese ka tregues qe humbje te renies se vleres te njohura me pare mund te mos ekzistojne me ose mund te jene pakesuar. Nese ekzistojne tregues te tille, Shoqeria vlereson shumen e rikuperueshme te aktivitetit apo NGP. Nje humbje e renies se vleres e njohur me pare rimerret vetem nese ka pasur ndryshime ne supozimet e perdorura per te percaktuar vleren e rikuperueshme te aktivitetit qe prej humbjes se renies se vleres te fundit te njohur. Rimarrja kufizohet deri ne masen qe vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vleren e rikuperueshme, si dhe nuk tejkalon vleren e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto nga amortizimi nese humbja nga renia e vleres nuk do te ishte njohur per aktivitetin ne vitet e kaluara. Nje rimarrje e tille njihet ne pasqyren e te ardhurave, pervec kur aktivi mbahet me kosto te rivleresuar , ne kete rast rimarrja do te trajtohet si nje rritje e rivleresimit.

h) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne pasqyren e pozicionit financiar perfshijne mjetet monetare ne banke dhe ne arke. Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsistojne ne mjete monetare sic percaktohet me siper.

i) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

j) Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

k) Angazhime dhe detyrime te mundshme



Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

Detyrimet e mundshme nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i mundshem nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te mundshme njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e pasqyres se pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes.

l) Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjetere ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjetere.

m) Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese per pozicionin e Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.

3 Gjykime, supozime dhe cmuarje te rendesishme

Pregatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise kerkon nga manaxhimi qe te perdore gjykimin, cmuarjet dhe supozime qe ndikojne mbi vlerat e raportuara te te ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe shpalosjeve te detyrimeve te kushtezuara, ne fund te periudhes raportuese. Megjithate, pasiguria ne keto supozime dhe cmuarje mund te rezultojne ne perfundime qe kerkojne nje rregullim material te vleres se mbartur te aktivitetit ose detyrimit qe ndikohet ne periudhat e mevonshme.

Cmuarjet dhe supozimet

Supozimet kryesore te lidhura me te ardhmen dhe burime te tjera kryesore te pasigurise ne cmuarje ne daten e raportimit, qe kane nje risk te madh te shkaktohet ne nje rregullim material te vleres se mbartur te aktivitetit dhe detyrimit brenda vitit financiar te ardhshem pershkruhen me poshte. Shoqeria i bazon supozimet dhe cmuarjet e saj ne parametra qe ekzistojne ne daten kur jane pregatitur pasqyrat financiare. Megjithate, rrethanat dhe supozimet ekzistuese ne lidhje me zhvillime te ardhshme, mund te ndryshojne per shkak te ndryshimeve ne treg, apo rrethanave qe jane jashte kontrollit te Shoqerise. Te tilla ndryshime reflektohen ne supozime kur ndodhin.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Jeta e dobishme eshte percaktuar ne baze te specifikimeve mbi vleren dhe jetegjatesine e aseteteve nga vet kompania.

Renia e vleres e aktiveve jo-financiare

Nje renie vlere ekziston kur vlera e mbartur e nje aktiviteti apo njesie gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme te tij qe eshte me e larta ndermjet vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim. Llogaritja e vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes bazohet ne te dhenat ekzistuese prej transakcioneve detyruese te shitjes ne transakcione me vlere tregu per aktive te ngjashme ose cmime tregu te vezhguara pakesuar me kostot shtese per nxjerrjen e aktivitetit jashte perdorimit. Llogaritja e vleres ne perdorim bazohet ne modelin e skontimit te flukseve monetare. Vlera



Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

e rikuperueshme eshte me e ndjeshme ndaj normes se skontimit te perdorur per modelin e skontimit te flukseve monetare, si dhe vlerave hyrese te pritshme dhe normes se rritjes te perdorur per qellim ekstrapolimi

Inventaret

Mallrat maten me, me te voglen ndermjet kosos dhe vleres neto te realizueshme. Ne percaktimin e vlerave neto te realizueshme, drejtimi mer parasysh evidencen me te besueshme ekzistuese ne kohën kur jane bere çmuarjet.

Analiza e Zerave te Bilancit
A- Aktivi

1-Aktivët afatshkurtra . Ato gjenden te pasqyruara per shumën **476,331,407** leke. Ato jane te analizuara si meposhte :

1. Per aktivet monetare gjithsej ne shumën **23,247,952** leke te paraqitur ne bilanc ne fund te vitit ; nga te cilat **2,256,902** leke jane ne banke dhe **20,991,051** leke ne arke.

2. Të drejta të arkëtueshme ne shumën **145,029,723** leke

2.1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne shumën **144,877,058** leke, e cila eshte e perbere nga gjendja e klienteve ne fund te vitit,

2.2 Të tjera ne shumën **152,665** leke e cila perfshin vlerën e taksave lokale te mbipaguara (teprice debitore) .

3. Gjendje inventari ne shumën **295,680,171** leke.

1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	1,336,912
2	Mallra	294,268,352
3	Parapagime për inventar	74,906
Totali		295,680,171

3.1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme vlerën 1,336,912 leke perfaqesohet nga vlera e inventarit te imet ne perdorim.

3.2 Mallra per rishitje e cila eshte ne shumën 294,268,352 leke dhe perfaqeson gjendje qe shoqeria ka inventar ne datën 31.12.2015. Gjendja e inventarit ne fund te vitit eshte e vleresuar me cmimin mesatar te blerjes.

3.3 Parapagime për inventar ne vlerën 74,906 leke perfaqesohet nga parapagimet e furnitoreve per blerje mallrash




L51715010G
Rruga e Kavajës, Nd. 124, H. 10, Kati 2,
Kod Postar, 1023,
Tiranë, Albania

Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

4. Shpenzime te shtyra ne shumen 12,373,562 leke

4.1 Shpenzime te shtyra ne vleren 12,373,562 leke perfaqesohet nga vlera e shpenzimeve per tu shpendare ne vite per investimet e kryera.

2-Aktivet afatgjata
1. Aktivet afatgjata materiale. Ato gjenden te pasqyruara per shumen 36,294,215 leke

Shoqeria nga transferimi i aktivitetit ka blere aktive afatgjata materiale neto ne shumen **43,475,273.14** leke.

Aktivet e qendrueshme sipas llojit te tyre jane pasqyruar ne llogarite perkatese analitike me koston e blerjes.

Per kete vit rezultojne shtesa dhe pakesime te aktiveve afatgjata materiale sipas tabelës .

Gjendja e aktiveve afatgjata, levizja e tyre, amortizimi i akumuluar dhe ai i llogaritur i vitit ushtrimor, si dhe gjendja neto e tyre sipas grupeve, paraqiten sipas tabelës se meposhteme :

PASQYRE PERMBLEDHES E AKTIVEVE AFATGJATA MATERIALE
Aktivet Afatgjata Materiale me vlera fillestare 2015

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje		Pakesime	Gjendje
			01/01/2015	31/12/2015		
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje		-	2,328,243.03	1,382.79	2,326,860.24
4	Mjete transporti		-	1,025,912.11	-	1,025,912.11
5	Mobilje dhe orendi		-	28,602,991.31	637,963.34	27,965,027.97
6	Zyre		-	9,663,225.03	152,291.60	9,510,933.43
7	Programe kompjuterike		-	1,031,381.68	-	1,031,381.68
8	Kompjuterike		-	2,206,638.14	42,398.89	2,164,239.26
9	Te tjera		-	225,148.66	20,465.39	204,683.27
	TOTALI		-	45,083,539.96	854,502.01	44,229,037.95

Amortizimi A.A.Materiale 2015

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje		Pakesime	Gjendje
			01/01/2015	31/12/2015		
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegja		-	230,040.03	23.05	230,016.98
4	Mjete transporti		-	107,283.45	-	107,283.45
5	Mobilje dhe orendi		-	4,840,913.90	10,632.72	4,830,281.18
6	Zyre		-	1,985,057.26	3,737.64	1,981,319.62
7	Programe kompjuterike		-	93,925.71	-	93,925.71
8	Kompjuterike		-	618,133.40	2,696.57	615,436.83
9	Te tjera		-	76,900.87	341.09	76,559.78
	TOTALI		-	7,952,254.63	17,431.07	7,934,823.56

Vlera Kontabeli Neto e A.A.Materiale 2015

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje		Pakesime	Gjendje
			01/01/2015	31/12/2015		
1	Toka		-	-	-	-
2	Ndertime		-	-	-	-
3	Makineri,paisje,vegja		-	2,098,203	1,360	2,096,843
4	Mjete transporti		-	918,629	-	918,629
5	Mobilje dhe orendi		-	23,762,077	627,331	23,134,747
6	Zyre		-	7,678,168	148,554	7,529,614
7	Programe Kompjuterike		-	937,456	-	937,456
8	Kompjuterike		-	1,588,505	39,702	1,548,803
9	Te tjera		-	148,248	20,124	128,123
	TOTALI		-	37,131,285	837,071	36,294,214

B- PASIVI

1-Detyrimet afatshkurtra . Ato gjenden te pasqyruara per shumen **496,560,997** leke. Ato jane te shpjeguara si meposhte :

1.1-Arketime ne avance per porosi ne vleren 8,090,070 leke ne te cilat perfshihen parapagime bere nga klientet per shitjet qe do te kryhen ne periudhen ne vazhdim.

2. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (Furnitoret) ne shumen **460,664,556** leke. Kjo llogari eshte e perbere nga gjendja e furnitoreve .

3. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore me vleren **9,201,073 Lek** ne te cilen perfshihen detyrime per paga ne Shumen **4,631,846 leke** ; Sigurime shoqerore dhe shendetsore ne Shumen **4,549,739 Leke**, dhe Detyrime Personel - Leje Lindje ne Shumen **19,488 leke**

4.Të pagueshme për detyrimet tatimore ne Shumen **18,605,298 leke** e cila perbehet nga :

- TAP per tu paguar ne vleren **689,818 leke**
- Shteti - TVSH per tu paguar ne vleren **13,763,187 leke**
- Tatim ne burim ne vleren **1,248,245 leke**
- Tatim Fitimin per tu paguar ne vleren **2,904,048 leke** paguar .

2 . Analiza e e Kapitalit

Kapitalet e veta	31 Dhjetor 2015
Kapitali nenshkruar	100,000
Rezerva ligjore	0
Rezultat I mbartur	0
Rezultati ushtrimor	15,964,624
Totali i Kapitalit	16,064,624

2.1 Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte ne shumen **100,000 leke**. Kapitali themeltar eshte **100,000 leke** i perbere nga **100 kuota** me vlere nominale **1,000 leke/kuota** dhe zoterohet nga nje ortak i vetem me **100 te aksioneve %**

2.2 Rezervat ligjore, jane paraqitur per **0 leke**.

2.3 Fitimi i pashperndare ne shumen **0 leke**.

2.4 Fitime dhe humbje te ushtrimit, perfaqesojne fitim neto te viti ushtrimor 2015, per shumen **15,964,624 leke**.

Kapitali themeltar eshte **100,000 leke** i perbere nga **100 kuota** me vlere nominale **1,000 leke/kuota** dhe zoterohet nga nje ortak i vetem me **100 te aksioneve %**




C-Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

1-Te ardhurat

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2015
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	844,800,146
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	107,180

2-Shpenzimet.

2.1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	778,908,975
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	700,334,020
	Të tjera shpenzime	78,574,956

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme ne vleren 778,908,975 leke e perbere nga kosto e mallrave te shitur te azhornuar me ndryshimin e gjendjeve sipas SKK.

2.1.1 Shpenzime te tjera, ne shumen 78,574,956 leke. Te detajuara si meposhte :

Nr. Llog.	Pershkrimi	Shp. Vjetor
62043	<u>Shpenzime Shtypshkrime</u>	245,040.01
62051	<u>Shpenzime Mirembajtje</u>	2,692,325.32
62061	<u>Shpenzime karburanti</u>	4,259,976.43
62062	<u>Shpenzime riparimi makinash</u>	548,540.70
62063	<u>Shpenzime Vaj Filtra</u>	177,505.17
62064	<u>Taksa Vjetore</u>	38,247.00
62065	<u>Shpenzime siguracion mjeti</u>	60,940.00
62066	<u>Shpenzime te Tjera</u>	1,500.00
62074	<u>Shpenzime Sigurimi Ambienti</u>	977,999.96
62081	<u>Shpenzime Noteriale</u>	17,043.34
62082	<u>Shpenzime Liqiore</u>	942,304.16
62113	<u>Shpenzime te Tjera Marketing</u>	17,782,892.04
62114	<u>ShpenzimeTe tjera Funkcionimi</u>	617,098.66
62121	<u>Shpenzime Udhetimi</u>	639,675.82
62131	<u>Shpenzime Pritje perciellie</u>	506,098.34
62132	<u>Shpenzime Materiale Pastrimi</u>	372,652.29



globe SHOPS
 L51715010G
 Rruga e Kavajës, Nd. 124, F. 10, Kat 2,
 Kod Postar 1023
 Tiranë, Albania

Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

Nr. Llog.	Pershkrimi	Shp. Vjetor
62133	Shpenzime Postare	1,420.00
62134	Shpenzime Konsulence Financiare	5,546,400.00
62135	Shpenzime te Ndryshme	129,953.16
6318	Komisione Bankare	1,914,170.26
644	Taksa Lokale	168,167.00
653	Subvencione te dhena	8,191.67
6091	Shpenzime te tjera ne Shtjje	2,100.00
673	Kuota e ushtrimi nga shpz e periudhave te ardhme	3,098,308.00
6654	Shpenzim Amortizim Inventar I imet	1,624,400.60
TOTAL		78,574,956

2.2-Shpenzimet e personelit, ne shumet totale 39,265,636 leke perbehen nga:

- Pagat e personelit per shumen 39,949,649 leke
- Kontributi per sigurime shoqerore dhe shendetesore per shumen 5,315,987 leke.

Keto shuma jane te njejta me shumet e te gjithë muajve te vitit ushtrimor sipas liste pagesave te paraqitura nga shoqeria. Pagat e personelit jane kontabilizuar per pagen bruto dhe shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore jane llogaritur dhe kontabilizuar vetem per pjesen qe i takon shoqerise.

2.3-Shpenzime amortizimi ne shumen 7,952,254.13 leke.

2.4- Shpenzime të tjera shfrytëzimi ne shumen 38,981 leke te cilat perfaqeson penalitete dhe gjoba fiskale dhe jo fiskale .

2.5-Shpenzime financiare ne vleren 127,193 leke e cila perbehet nga shpenzime interesa bankare ne vleren 536 leke dhe 126,657 leke Fitim nga Kembimet valutore

Shifren e afarizmit

RAKORDIMI I TE ARDHURAVE ME DEKLARIMIN NE FDP

Nr	Muaji	Total Vlerat ne FDP	Vlera Totale			TVSH	Qarkullimi total	Shifra e afarizmi	Diferenca
			Shtjjet e Perjashtuara	sporte molera e Tatueshm					
1	Janar	-					-	-	
2	Shkurt	-					-	-	
3	Mars	-					-	-	
4	Prill	-					-	-	
5	Maj	-					-	-	
6	Qershor	-					-	-	
7	Korrik	149,023,195	-	-	124,185,996.00	24,837,199.00	124,185,996.00	123,217,359	968,637.33
8	Gusht	127,196,097	20,000.00	-	105,990,081.00	21,196,016.00	106,000,081.00	100,800,158	5,199,923.47
9	Shtator	140,783,718	10,000.00	-	117,311,432.00	23,462,286.00	117,321,432.00	112,014,179	5,307,252.63
10	Tetor	155,144,085	10,000.00	-	129,278,404.00	25,855,681.00	129,288,404.00	122,025,674	7,262,729.92
11	Netor	158,963,110	22,500.00	-	132,450,508.00	26,490,102.00	132,473,008.00	139,361,365	(6,888,357.29)
12	Dhjetor	293,584,266	22,500.00	-	244,634,805.00	48,926,961.00	244,657,305.00	248,417,794	(3,760,488.66)
Total		1,024,694,471.00	85,000.00	-	853,841,226.00	170,768,245.00	853,926,226.00	845,836,528.60	8,089,697.40

Diferenca e deklarimit te FDP-ve me Shifren e Afarizmit eshte ne vleren 8089697.4 dhe perbehet nga :

Deklaruar me teper ne FDP	8,089,697.40
1- Paradhenie te vitit 2015	8,090,070.51
2- Diferenca te tjera	373.11
3-Hua	



globe SHOPS
 L51715010G
 Rruga e Kavajes, Nd. 124, H. 10, Kati 2,
 Kod Postar, 1023,
 Tirane, Albania

Pasqyra te tjera te Kerkuara

➤ Tabela e Mjeteve ne Pronesi

TABELA E T MJETEVE TE TRANSPORTIT NE PRONESI

Nr.	Pershkrimi	Modeli-Tipi	Targa	Kapaciteti
1	Autoveture	Vosvagen golf	AA564AM	4+1
2	Motorciklete	Dayang DY 50-2	TR046C	1+0
3	Autoveture	Volsw agen Polo	TR7367P	4+1
4	Furgon	Volsw agen	AA562AM	2+1
5	Motorciklete	Dayang DY 50-2	CAA233	1+1
6	Motociklete + Kosh per motorrin	Lifan	CAD664	1+0

1 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Ceshtje gjyqesore

Me 31 Dhjetor 2015 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

2 Objektivat dhe politikat e manaxhimit te riskut financiar


Detyrimet financiare kryesore te Shoqerise perbehen nga llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime. Qellimi kryesor i ketyre detyrimeve financiare eshte te financojne operacionet e Shoqerise dhe te sigurojne garanci per mbeshtetjen e operacioneve. Shoqeria ka hua dhe llogari te arketueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra qe sigurohen drejteperdrejte nga operacionet e saj. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te tregut, riskut te kreditit dhe riskut te likuiditetit. Manaxhimi i larte i Shoqerise mbikqyr manaxhimin e ketyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne cmimet e tregut. Cmimet e tregut perfshijne kater tipe risqesh: risku i normes se interesit, risku i kursit te kembimit, risku i cmimit te mallrave dhe risqe te tjera te cmimeve, te tilla si risku i cmimit te kapitalit. Instrumentat financiar te prekur nga risku i tregut perfshijne huate dhe kredite dhe depozitat.

Risku i normes se interesit

Risku i normes se interesit perbehet nga risku qe vlera e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit ne treg dhe riskut qe maturitetet e aktiveve qe mbartin interes te ndryshojne nga maturitetet e detyrimeve qe mbartin interes te perdorura per te financuar ato aktive. Zgjatja kohore pergjate te ciles norma e interesit e nje instrumenti financiar eshte fikse, percakton se ne cfare mase eshte e ekspozuar ndaj riskut te normes se interesit. Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqerise mbartin norma interesi te tregut. Me 31 Shoqeria nuk ka vlera te konsiderueshme detyrimesh financiare qe mbartin interes dhe si rrjedhoje nuk ka perqendrim te madh te riskut te normes se interesit.



Pasqyrat Financiare- Shenime Shpjeguese (vazhdim)

Risku i kursit te kembimit

Risku i kursit te kembimit eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne kursin e kembimit te monedhave te huaja.

Risku i kreditit

Risku i kreditit eshte risku qe nje pale tjetër nuk do te jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj qe rrjedhin nga nje instrument financiar ose marreveshje klienti, duke cuar keshtu ne nje humbje financiare. Risku i kreditit eshte i ulet.

Risku i likuiditetit


Risku i likuiditetit eshte risku qe Shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Risku i likuiditetit eshte risk i qenesishem ne biznesin e Shoqerise pasi disa aktive specifike te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Nese Shoqeria do ti duhet te kete shuma te medha ne nje afat te shkurter kohor qe tejkalon kerkesat normale per mjete monetare mundet qe te ndeshet me veshtiresi per te siguruar cmime joshese. Shoqeria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhe profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

Manaxhimi i kapitali

Kapitali perfshin kapitalin qe i perket mbajtesve te pjeseve kapitalit te shoqerise meme. Objektivi kryesor i manaxhimit te kapitalit te Shoqerise eshte te siguroje qe po mban nje kapital te shendoshe per te mbeshtetur biznesin e saj dhe te maksimizojë vleren e aksionereve. Shoqeria manaxhon strukturen e kapitalit te saj dhe ben rregullimet e nevojshme ne rast se ka ndryshime ne kushtet ekonomike. Per te ndryshuar apo mbajtur strukturen e saj te kapitalit, Shoqeria mund te rregulloje shperndarjen e dividendit per aksioneret e saj, t'ju ktheje kapitalin aksionereve ose te emetoje aksione te reja.

3 Ngjarjet pas dates se bilancit

Me 31 Dhjetor 2015 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.



Shefe Finance



Administrator



Date 30.03.2016

Per: Drejtorine Rajonale te Tatimeve
Tirane

Lenda: Auditimi i pasqyrave financiare te subjektit Globe Shops sh.p.k
Tirane

Te nderuar zoterinj;

Nepermjet kesaj letre deshirojme t'ju njoftojme se shoqeria UHY Elite sh.p.k (shoqeri e Eksperteve Kontabel te Regjistruar), eshte emeruar per te kryer auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2015 per shoqerine Globe Shops sh.p.k nga ortaket e kesaj shoqerie. UHY Elite eshte ne procesin e auditimit, dhe per shkak te kohes se kufizuar, nuk ka mundesi qe te perfundoje auditimin e pasqyrave financiare brenda dates 31.03.2016.

Me respekt,

UHY Elite sh.p.k
Artan Golemi EKR

